

# Indeksi i Çmimeve të Konsumit

## Mars, 2016

**Tiranë, më 08 Prill 2016:** Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Mars 2016, arriti 102,5 % kundrejt muajit Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100).

**Në muajin Mars 2016 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 0,3 %.** Një vit më parë ky ndryshim ishte 2,2 %.

### **Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.**

Rritja vjetore në muajin Mars është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,81 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,13 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” dhe “Hotele, kafene e restorante” kanë kontribuar respektivisht me + 0,05 dhe + 0,03 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,28 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me -0,18 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” kanë kontribuar me nga -0,09 pikë përqindje secili. (shih Fig 2. fq 2).

**Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Mars 2015, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shërbimi arsimor” me 4,8 % pasuar nga grupi, “Pije alkoolike dhe duhan” me 2,6 %, grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike me 2,2 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 28,1 %, pasuar nga nëngrupi “zarzavate përfshirë patatet” me 8,7 %, nëngrupi “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 1,5 %, nëngrupi “vajra dhe yndyrna” me 0,6 % etj. Çmimet e nëngrupit “qumësht, djath e vezë” u ulën me 3,7%, pasuar nga nëngrupet “bukë e drithëra” me 2,2 %, “kafe, çaj e kakao” me 1,3 %,etj. Ndërsa, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Transport” me 4,5 %, pasuar nga grupet “Shëndeti” me 2,2 %, “Veshje dhe këpucë” me 2,4 %, etj.

**Ndryshimi mujor i indeksit është 0,4 %.** Krahasuar me muajin Shkurt 2016, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije alkoolike” me 1,1 %. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mobilim” me 0,3 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit





Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



**Shënim:** Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit shpreh kontributin që jep secili grup shpenzimesh në ndryshimin vjetor të shprehur në pikë përqindje. Shuma e kontributeve me vlera pozitive dhe negative jo domosdoshmërisht jep ndryshimin vjetor për shkak të rumbullakimeve gjatë procesit të llogaritjeve. Psh. edhe pse indeksi i grupit "Pije alkoolike dhe duhan" në muajin Mars 2016 u rrit me 2,6 %, kontributi në ndryshimin vjetor është + 0,13 pikë përqindje.

**Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit**

Dhjetor 2015=100 %

Kodi	Grupet	Peshat	03-15	04-15	05-15	06-15	07-15	08-15	09-15	10-15	11-15	12-15	01-16	02-16	03-16
<b>Gjithsej</b>		<b>100,0</b>	<b>102,2</b>	<b>101,7</b>	<b>100,1</b>	<b>99,0</b>	<b>98,4</b>	<b>99,1</b>	<b>99,7</b>	<b>99,7</b>	<b>99,4</b>	<b>100,0</b>	<b>100,9</b>	<b>102,0</b>	<b>102,5</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	36,1	104,7	103,8	100,1	97,8	96,3	98,2	99,4	99,3	98,7	100,0	102,5	105,9	107,0
2	Pije alkoolike dhe duhan	5,0	98,6	99,1	99,3	99,6	99,3	99,5	99,5	99,6	99,4	100,0	100,5	100,8	101,2
3	Veshje dhe këpucë	4,0	100,8	100,6	100,4	99,8	99,3	98,5	98,5	99,3	99,8	100,0	99,4	98,1	98,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,3	101,6	100,1	100,0	100,2	100,3	100,3	100,3	100,0	100,0	100,0	100,7	100,7	100,7
5	Mobililje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	99,3	99,4	99,6	99,4	99,5	99,6	99,5	99,4	99,5	100,0	100,3	100,3	100,0
6	Shëndeti	3,9	102,4	102,8	102,8	99,6	100,1	100,1	100,3	100,5	100,0	100,0	100,0	100,1	100,2
7	Transporti	6,3	100,8	101,6	101,9	102,3	102,7	102,0	101,2	101,2	100,0	100,0	96,7	95,8	96,3
8	Komunikimi	2,8	101,0	101,0	101,1	101,1	101,1	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,3
9	Argëtim dhe kulturë	2,8	99,4	99,3	99,4	99,3	98,9	99,1	100,0	100,2	100,1	100,0	100,2	100,1	100,1
10	Shërbimi arsimor	3,9	95,4	95,4	95,4	95,4	95,4	95,8	96,2	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,6	99,0	99,0	99,0	99,1	99,1	99,2	100,0	100,0	99,9	100,0	100,0	100,0	100,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,9	99,9	100,3	100,4	100,3	99,9	99,7	100,6	100,2	100,4	100,0	100,0	100,1	100,1

**Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	03-15/03-14	04-15/04-14	05-15/05-14	06-15/06-14	07-15/07-14	08-15/08-14	09-15/09-14	10-15/10-14	11-15/11-14	12-15/12-14	01-16/01-15	02-16/02-15	03-16/03-15
<b>Gjithsej</b>		<b>2,2</b>	<b>2,3</b>	<b>1,8</b>	<b>1,4</b>	<b>1,3</b>	<b>1,9</b>	<b>2,2</b>	<b>2,1</b>	<b>2,1</b>	<b>2,0</b>	<b>1,5</b>	<b>0,2</b>	<b>0,3</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,7	5,2	3,8	2,7	2,4	4,2	4,9	5,5	5,9	5,1	4,3	2,2	2,2
2	Pije alkoolike dhe duhan	6,3	6,5	6,8	7,0	6,6	6,7	6,9	6,1	3,3	3,3	3,3	2,6	2,6
3	Veshje dhe këpucë	-0,9	-1,3	-1,2	-1,3	-1,0	-1,6	-2,1	-3,7	-4,0	-3,2	-3,7	-3,4	-2,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,3	-1,0	-0,8	-0,4	-0,3	-0,3	-0,2	-1,4	-1,7	-2,0	-1,3	-1,3	-0,9
5	Mobililje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	-0,3	-0,1	-0,1	-0,1	-0,1	-0,4	-0,3	0,0	0,6	0,9	1,1	0,7
6	Shëndeti	-4,4	-1,5	0,1	-1,9	-0,8	-0,9	-0,6	-0,5	-1,3	-0,9	-1,6	-2,2	-2,2
7	Transporti	-2,2	-1,5	-1,4	-1,1	-0,9	-1,9	-2,5	-2,1	-2,8	-0,6	-2,5	-4,1	-4,5
8	Komunikimi	3,7	2,3	2,2	2,2	1,7	0,6	0,0	0,0	-0,8	-1,1	-1,1	-1,0	-0,7
9	Argëtim dhe kulturë	0,6	0,5	0,5	0,4	0,1	0,2	0,4	1,0	1,0	1,1	1,2	0,7	0,8
10	Shërbimi arsimor	10,3	10,1	10,1	10,1	10,1	10,4	10,5	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,6	0,6	0,5	0,4	0,3	0,5	0,8	0,6	0,7	1,1	1,0	1,0	1,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-1,7	-1,1	-1,0	-0,8	-0,7	-0,7	-0,1	-0,6	-0,1	-0,2	-0,1	0,2	0,2

**Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

Kodi	Grupet	03-15	04-15	05-15	06-15	07-15	08-15	09-15	10-15	11-15	12-15	01-16	02-16	03-16
	<b>Gjithsej</b>	<b>0,4</b>	<b>-0,5</b>	<b>-1,6</b>	<b>-1,1</b>	<b>-0,7</b>	<b>0,8</b>	<b>0,6</b>	<b>0,01</b>	<b>-0,3</b>	<b>0,6</b>	<b>0,9</b>	<b>1,1</b>	<b>0,4</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,0	-0,8	-3,6	-2,3	-1,5	2,0	1,2	-0,1	-0,6	1,3	2,5	3,3	1,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	0,5	0,2	0,3	-0,3	0,2	0,0	0,1	-0,2	0,6	0,5	0,3	0,4
3	Veshje dhe këpucë	-0,7	-0,1	-0,3	-0,5	-0,5	-0,9	0,1	0,8	0,5	0,2	-0,6	-1,3	0,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,5	-1,5	-0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	-0,3	0,0	0,0	0,7	0,0	0,0
5	Mobillje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,1	0,1	0,1	-0,1	0,1	0,1	-0,2	-0,1	0,1	0,5	0,3	0,0	-0,3
6	Shëndeti	0,0	0,4	0,0	-3,1	0,4	0,0	0,3	0,2	-0,5	0,0	0,0	0,1	0,1
7	Transporti	1,0	0,8	0,3	0,4	0,4	-0,7	-0,8	0,0	-1,2	0,0	-3,3	-0,9	0,5
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-1,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,3
9	Argëtim dhe kulturë	-0,1	0,0	0,1	-0,1	-0,4	0,2	0,9	0,2	-0,1	-0,1	0,2	-0,1	0,0
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,4	0,5	3,9	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,2	0,8	0,0	-0,1	0,1	0,0	0,0	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	0,5	0,1	-0,1	-0,4	-0,2	0,9	-0,4	0,2	-0,4	0,0	0,1	-0,1

%

# Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), duke filluar nga muaji Janar 2016 llogaritet me shportën e re të artikujve, peshat e të cilave janë llogaritur bazuar në shpenzimet e Anketës së Buxhetit të Familjes, realizuar nga INSTAT gjatë vitit 2014. Muaji Dhjetor 2015 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2015 = 100). Ndryshimi i mëparshëm i shportës së artikujve është bërë në muajin Janar të vitit 2007, ku numri total i artikujve u rrit nga 262 në vitin 2002 në 271 artikuj. Në shportën e re numri total i artikujve është 333. Indeksi llogaritet dhe publikohet duke përdorur strukturën e Klasifikimit të Shpenzimeve sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 grupe kryesore, tërësisht të përputhshëm me klasifikimin e shpenzimeve që përdor EUROSTAT.

Ashtu si indeksi i mëparshëm edhe indeksi i ri do të mbulojë gjithë territorin e vendit (koncepti i peshave). Çdo produkt përfaqësohet në indeks me tre lloje peshash : pesha e produktit në nivel vendi, pesha e produktit në nivel qarku dhe pesha gjeografike. Indeksi do të vazhdojë të publikohet në nivel vendi. Çmimet do të mbliidhen në zonën urbane në 11 qarqe, përjashtuar qarkun e Kukësit i cili në indeks përfaqësohet nga qarku i Dibrës.

Për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Shqipëri përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0,i}^t = \frac{\sum_i P_i^t * Q_i^0}{\sum_i P_i^0 * Q_i^0}$$

Peshat (w = P\*Q) e periudhës bazë janë përdorur për llogaritjen e indeksit:

$$I_{0,i}^t = \sum_i w_i * \left( \frac{P_i^t}{P_i^0} \right)$$

Në mënyrë më të detajuar, çmimi relativ është llogaritur për çdo produkt dhe çdo qark duke përdorur mesataren gjeometrike :

$$PR_{t-1,ij}^t = \prod_{k=1}^n \left( \frac{P_{ijk}^t}{P_{ijk}^{Dec(t-1)}} \right)^{1/n}$$

Lidhja zinxhir me indeksin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm jep çmimin relative krahasuar me periudhën bazë.

$$PR_{0,ij}^t = PR_{0,ij}^1 * \dots * PR_{Dec(t-1),ij}^t$$

IÇK rajonale llogaritet si më poshtë.

$$RIÇKI_{i,0}^t = \sum_i r_{ij} * PR_{0,ij}^t$$

Çmimet relative agregohen me peshat gjeografike për të formuar indekset e çdo produkti për gjithë Shqipërinë.

$$I_{0,i}^t = \sum_j r_{ij} * PR_{0,ij}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_j r_{ij} = 1 \quad : \quad \forall_i \text{ (për të gjitha rastet)}$$

Agregimi për të gjitha produktet jep IÇK e Shqipërisë:

$$IÇK_0^t = \sum_i w_i * I_{0,i}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_i w_i = 1$$

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

$$\text{Ndryshimi vjetor} = \left( \frac{I_{m_t}^{y_t}}{I_{m_t}^{y_{(t-1)}}} - 1 \right) * 100$$

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

$$\text{Ndryshimi mujor} = \left( \frac{I_{m_t}^{y_t}}{I_{m_{(t-1)}}^{y_t}} - 1 \right) * 100$$

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

$$\text{Ndryshimi mesatar vjetor} = \left( \frac{I_{mes}^{y_t}}{I_{mes}^{y_{(t-1)}}} - 1 \right) * 100$$

Legjenda:

P çmimi

PR çmimi relativ

*I* indeksi

IÇK Indeksi i Çmimeve të Konsumit

t periudha korente t

t=0 periudha bazë 0

r peshat gjeografike

w peshat e produkteve

j numri i prefekturave

i numri i produkteve

$I_{m_t}^{y_t}$  indeksi mujor i vitit korent

$I_{m_t}^{y_{(t-1)}}$  indeksi mujor i vitit të mëparshëm

$I_{m_{(t-1)}}^{y_t}$  indeksi i muajit të mëparshëm të vitit korent

$I_{mes}^{y_t}$  indeksi mesatar i vitit korent

$I_{mes}^{y_{(t-1)}}$  indeksi mesatar i vitit të mëparshëm